



Data: 18.05.2018

Ref.: 485/18D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë: 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 55-të, të mbajtur më 10 Maj 2018, mori:

V E N D I M

I. Nuk akreditohet programi i studimit i BPrAL Kolegji “Arbëri”:

- Infermieri, BSc, 180 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji “Arbëri” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programit të studimit: Infermieri, BSc. 180 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Infermieri	BSc	180	Zejdush Tahiri, Fellenza Spahiu, Musa Qazimi

AKA ka organizuar vizitë në Kolegjin “Arbëri” më 20.09.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekur me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Danica Zeleznik dhe Tatjana Gec.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 10 Maj 2018 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegji “Arbëri”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve raporti i vetëvlerësimit është i varfër në përmbajtje të programit, dhe me tepër fokusohet në përshkrimin e institucionit.

Programi i studimit në Infermieri nuk korrespondon me misionin e institucionit dhe se misioni i Kolegjit nuk adreson rëndësinë e arsimit të lartë për të rinjtë dhe hulumtimin shkencor, si dhe rëndësinë që ka në shoqërinë e Kosovës.

Ekspertet vlerësojnë se kurrikula nuk është përmirësuar përkundër rekomandimeve të dhëna gjatë vlerësimit të mëhershëm në muajin Maj. Disa lëndë vazhdojnë të përmbajnë ore klinike praktike, dhe mbrojtësit e programit nuk kanë arritur të qartësojnë se cilat shkathtësi do duhej të fitoj studentit nga këto ore. Gjithashtu ngarkesa e orëve dhe vendosja e lëndëve nuk është bërë në mënyrë adekuate. Lëndëve me rëndësi u janë dhënë ngarkesë e pa mjaftueshme ndërsa disa lëndë janë vendosur në vitin e tretë, dhe do duhej të ishin në vitin e parë.

Për sa i përket stafit akademik, asnjëri nga stafi nuk ka PhD në fushën e Infermierisë.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji "Arbëri";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

